



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, par.1 pika b të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, dhe të nenit 19, par.1, pika b të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt.16.3.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 17.05.2007, merr

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT PËR VENDOSJEN E QOSHQEVE NË QYTETIN E PRISHTINËS

Neni 1

Miratohet Vendimi i planit për vendosjen e qoshqeve në qytetin e Prishtinës.
Plani, nga paragrafi 1 i këtij neni, përmban pjesën tekstuale dhe grafike, të cilat paraqesin pjesë përbërëse të këtij Vendimi.

Neni 2

Plani për vendosjen e qoshqeve, i miratuar me këtë Vendim, është hartuar nga Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës, si detyrë e caktuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-110-24896, të dt. 28.10.2005.

Neni 3

Vendosja e qoshqeve në lokacionet e planifikuara sipas planit të miratuar me këtë Vendim, do të ketë karakterin e përkohshëm.

Në lokacionet e planifikuara sipas planit të miratuar me këtë Vendim, do të lejohet vendosja e qoshqeve sipas zgjidhjes arkitektonike të kësaj kategorie të objekteve të përkohshme, sipas konkursit të shpallur e të zgjedhur, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Neni 4

Plani i miratuar me këtë Vendim paraqet fazën e dytë të hartimit të planit për vendosjen e qoshqeve, në pajtim me nenin 3 të Vendimit për hartimin e planit për vendosjen e qoshqeve në qytetin e Prishtinës nr. 01-110-24896, të dt. 28.10.2005.

Neni 5

Leja për vendosjen e qoshqeve në lokacionet e planifikuara në planin e miratuar me këtë Vendim, lëshohet nga Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë.

Neni 6

Mënyra dhe procedurat e dhënies në shfrytëzim të lokacioneve të planifikuara me planin e miratuar me këtë Vendim, do të bëhet sipas procedurave të parapara ligjore.

Neni 7

Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01.Nr. 353-200 dt 17.05.2007

KRYETARI I KUVENDIT

Ismet Beqiri